



KËSHILLI DREJTUES

V E N D I M Q A R K U L L U E S

Nr. 38, datë 15.12.2020

**Mbi miratimin e buxhetit të  
Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin 2021**

Në mbështetje të nenit 44, pika 1, shkronja “a”, të nenit 52, pika 1, shkronja “gj”, të nenit 53, pika 5, shkronja “f” të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, të nenit 18, pika 1, shkronja “b” të Rregullores nr. 34, datë 27.11.2020 “Për hartimin, miratimin dhe zbatimin e Buxhetit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, të ndryshuar, të nenit 7, pika 6 të Statutit të Agjencisë, miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues nr. 24, datë 31.10.2018, si dhe të nenit 10, pika 6 dhe nenit 18 të vendimit të Këshillit Drejtues nr. 29, datë 03.11.2014 “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave” me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues

---

V E N D O S I:

1. Miratimin e buxhetit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin 2021, sipas materialit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Autorizohet Drejtori i Përgjithshëm për dërgimin në Autoritet Mbikëqyrës të njoftimit për miratimin e buxhetit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin 2021, si dhe një kopje të tij.
3. Ngarkohen të gjitha njësitet organizative të Agjencisë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Martin Blushi

**Sekretar**

Donald Duraj

**Kryetar**